



Crna Gora / Mali i Zi  
Opština Ulcinj  
Komuna e Ulqinit  
Sekretarijati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji  
e-mail: [zecarije.sulejmanovic@ul-qov.me](mailto:zecarije.sulejmanovic@ul-qov.me)  
[agroui@ul-qov.me](mailto:agroui@ul-qov.me)

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu  
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi

Br./Nr. 17- 070/23-86/1

Ulcinj/Ulqin, 09.09.2023. god. vit

Sekretarijati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji në bazë të nenit 42 të Vendimi për Masat Stimuluese për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ("Fletorja zyrtare MZ-dispozitat komunale numër 46/16 dhe 18/19), në pajtushmëri me Buxhetin e Komunës së Ulqinit dhe me Planin e shfrytëzimit të mjeteve për mbështetje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2023 numër 01-082/23-777/2, shpall:

### **THIRRJEN PUBLIKE** **Për ndarjen e mjeteve mbështetese për aktivitetet e prodhimit bimor për vitin 2023**

#### **SUBJEKTI I THIRRJES**

Në kuadër të masave mbështetëse për prodhimin bimor për vitin 2023, përfituesi realizon të drejtën e mjeteve mbështetëse për materialin mbjellës (fidanor) dhe blerjen e pajisjeve për zhvillimin e prodhimit bimor.

#### **PËRKUFIZIMI I PËRDORËSVE TË MBËSHTETJEVE**

Të drejtën e mbështetjes sipas kësaj thirrje publike kanë personat fizik dhe juridik. Personat fizik duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e amvisërive bujqësore, në pajtim me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Fletorja zyrtare MZ, numër 59/21).

Nëse dorëzuesit e kërkesës janë persona juridik veprimtaria e tyre primare duhet të jetë nga sektori A: bujqësia, pylltaria, peshkimi, në pajtushmëri me Ligjin për klasifikim të veprimtarive („Fl. Zyrtare e MZ“, numër 152/22).

Dorëzuesi i kërkesës duhet të ketë vendbanimin, gjegjësisht selinë në territorin e komunës së Ulqinit dhe veprimtarinë bujqësore ta ushtrojë në komunën e Ulqinit.

#### **INVESTIMET E PRANUESHME**

Investimet që mbështeten me këtë thirrje janë:

- Blerja e makinerive dhe pajisjeve për përgatitjen e tokës, mbjelljen, korrjen, klasifikimin, paketimin dhe ruajtjen e frutave dhe perimeve, folie të zeza;
- Blerja e farës dhe materialit fidanor, si dhe e materialit I cili përdoret në mbjelljen dhe mirëmbajtjen e plantacioneve, pemishteve (kunjë, rrjeta mbrojtëse, mjete mbrojtëse dhe ushqimore);
- Blerja e sistemeve të ujitjes (pompat, tubacionet e furnizimit me ujë, tubacionet e shpërndarjes, lidhësit, etj.).

#### **SHUMA E MBËSHTETJES**

Për mbështetjet e përmendura, sipas Planit të përdorimit të mjeteve janë të dedikuara gjithsej **17.000,00€** për vitin 2023.

Shuma e mbështetjes është 50 %, nga shpenzimet totale të pranueshme të investimit. Për blerjen e materialit fidanor është 60%.

Shuma maksimale për shfrytëzues është deri në **700.00 €**.

#### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PRANUESHMËRISË**

**Të drejtën për mbështetje shfrytëzuesi mund ta realizojë nëse:**

- i plotëson të gjitha kushtet sipas Vendimit për masat stimuluese për zhvillim bujqësor dhe rural;
- nuk ka obligime tatimore të pashlyera ndaj administratës lokale;

- për të njëjtin investim nuk ka marr mjete nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave.

Me këto masa **nuk mbështetet:**

- shpenzimet e importit, transportit dhe detyrimeve të ngjashme
- blerja e paisjeve dhe mekanizimit të përdorur,
- shpenzimet tatimore, doganore, importi, taksat administrative dhe të ngjashme,
- blerja dhe marrja me qira të tokës bujqësore dhe objekteve ekzistuese,
- shpenzimet e mjeteve qarkulluese dhe shpenzimet operative,
- shpenzimet e punës së vet (pagat, kontributet).

### **KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË**

Shfrytëzuesit duhet të posedojnë tokë bujqësore për mbjellje dhe të jenë të regjistruar në Regjistrin e Prodhuesve Bujqësor.

Mbjelljet duhet të jenë në një sipërfaqe minimale prej 1000 m<sup>2</sup>.

Shfrytëzuesit duhet të posedojnë tokë bujqësore për rritjen e perimeve dhe kulturave bujqësore.

Sipërfaqet minimale për të mbështetur prodhimin e kulturave të caktuara janë:

- kultivim në fushë të hapur

- Sipërfaqja minimale 1000m<sup>2</sup>

- hapësirë e mbrojtur (sera)

- Sipërfaqja 200m<sup>2</sup> (kjo sipërfaqe duhet të jetë në një tërësi)

Kërkesës për blerjen e materialit fidanor i bashkëngjitet deklarata për cilësinë e materialit fidanor.

### **DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:**

- Kërkesa për pranimin e mbështetjes/investimin;
- Vendimi i regjistrimit të amvisërisë bujqësore që e lëshon Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ujërave (numri ID i amvisërisë);
- Vendimi nga Regjistri i prodhuesve të ullinjëve dhe/ose regjistri i prodhuesve;
- Për persona juridik ekstrati nga CRPS, (regjistri qendror për subjete ekonomike) ;
- Dëshmia e pronësisë ose e shfrytëzimit të pronës (fleta poseduese jo më e vjetër se 6 muaj, kontrata e shfrytëzimit etj.);
- Deklarata e vërtetuar se për këtë mbështetje nuk janë përfituar mjete nga organet shtetërore ose administrata lokale;
- Fotokopia e letërnjoftimët të dorëzuesit të kërkesës;
- Vërtetimi se aplikanti nuk ka obligime tatimore ndaj organeve të admin. lokale;
- Kopia e fletëgarancisë për paisjen e blerë
- Dëshmia se paisja është paguar në formën e:
  - faturës fiskale me dëshmi pranimi me emrin e blerësit;
  - në rastin e pagesës përmes xhiro-llogarisë (pagesat llogaritare) udhër-pagesa e vërtetuar (e pagesës) për transferin e mjeteve shitësit dhe fatura e verifikuar;
  - dëshmit tjera specifike të parapara me kriteret specifike të pranueshmërisë.

### **SI TË DËRGONI KËRKESËN**

Formulari i Kërkesës për mbështetje aktiviteteve për prodhimin bimor për vitin 2023 mund ta merrni në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji si dhe në Byronë e qytetarëve të Komunës së Ulqinit.

Formularin e plotësuar të kërkesës dhe dokumentacionin përcjellës e dërgoni me postë të regjistruar në adresën:

**Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji**

**Kërkes sipas Thirrjes publike për ndarjen e mjeteve mbështetëse për aktivitetet e prodhimit**

**bimor për vitin 2023**  
**Bulevardi Skenderbeg,**  
**85360 Ulcinj**

**Afati i dërgimit të kërkesës është 15 nëntor 2023**, gjegjësisht deri në ndarjen e mjeteve të dedikuara për realimin e këtij programi.

Nëse mjete shpenzohen para datë së 15 nëntor 2023, Thirrja publike do të mbyllet për çka do të informohen prodhuesit.

#### **PROCEDURA E REALIZIMIT**

Sekretariati (komisioni) do të vizitojë prodhuesit që kanë dorëzuar dokumentacionin, para se të lejohet mbështetja financiare, për të bërë verifikimin në vend të të dhënave dhe kushteve të parapara me Vendimin për masat stimuluese për bujqësi dhe zhvillim rural dhe me këtë Thirrje, dhe për këte bënë procesverbalin me vlerësim dhe mendim për plotësimin e kushteve për përfitimin e mjeteve mbështetëse financiare.

Nëse shfrytëzuesi nuk lejon ose ndalon punën e Sekretariatit (komisionit) në terren, ose në ndonjë mënyrë tjetër ndikon në punën e tij, kërkesa e shfrytëzuesit do të refuzohet.

Në bazë të dokumentacionit të dërguar dhe shqyrtimit në vend Sekretariati (komisioni) konstaton a janë të plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për mjete dhe me aktvendim lejon pagesën e mjeteve mbështetëse financiare.

Shfrytëzuesit duhet t'i shpenzojnë mjetet mbështetëse për atë që janë dedikuar dhe nuk mund t'i tjetërsojnë ata, ose t'i japin dikujt tjetër për përdorim investimin sipas kësaj kërkesë, në periudhën 5 vjeçare prej ditës së përfitimit.

Kontrolin e shpenzimit të mjeteve të lejuara për mbështetje në kontinuitet do ta ushtrojë organi kompetent për punët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Shfrytëzuesit që përdorin mbështetjen për qëllime jo të synuara, me vendim të organit kompetent, humbasin të drejtën e mbështetjes për çka Sekretariati nxjerr vendim të posaçëm me të cilin urdhërohet përfituesi të kthej mjetet.

Në këtë rast, përfituesi obligohet të kthej mjetet e përfituara plotësisht në afatin prej 30 ditëve prej marrjes së vendimit.

Personat që kanë dhanë të dhëna jo të sakta në kërkesën e tyre, e të cilat i konstaton organi kompetent, nuk kanë të drejtë në masat mbështetëse.

Përfituesit duhet të ruajnë dokumentacionin në bazë të së cilët kanë fituar të drejtën për masën mbështetëse, më së paku pesë vjetë prej ditës së marrjes së mjeteve mbështetëse. Aplikanti kërkesa e të cilit refuzohet do të lajmërohet për shkaqet e refuzimit. Normat ndëshkuese janë të normuara në nenin 49 dhe 50 të Vendimit për masat mbështetëse për zhvillim bujqësor dhe rural.

#### **VËREJTJE:**

Kerkesat e arritura pas afatit Sekretariati nuk do ti shqyrtojë.

Sekretariati do të pranoj si të vlefshme faturat e vitit 2023 deri në datën e skadimit të afatit të thirjes publike (15.11.2023).

Informatat në lidhje me Thirrjen publike mund të merren në e-mail [agroul@ul-gov.me](mailto:agroul@ul-gov.me) ose personalisht në zyren e Sekretariatit për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji.